



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**MBI PROGRAMIN KOMBËTAR TË BURSIVE PËR SHKËMBIME AKADEMIKE
NË SLOVAKI**

Qeveria e Republikës së Sllovakisë ka shpallur Programin Kombëtar të Bursave të Republikës së Sllovakisë (National Scholarship Program-NSP of the Slovak Republic) për shtetasit e huaj, të cilët dëshirojnë të kryejnë studime, kërkime pranë universiteteve sllovaqe, organizatave kërkimore, institucioneve të artit, etj. Ky program synon të mbështesë me bursë shkëmbimet e studentëve të huaj universitarë dhe pasuniversitarë, të doktoratës, pedagogeve të universitetit, studiuesve dhe specialistëve, etj. (me kohëzgjatje nga 1-10 muaj) për vitin akademik 2020-2021, në programet e studimit:

- **Master (1-2 semestra):** Të gjithë kandidatët duhet të jenë të pajisur me një diplomë Bachelor ose të kenë kryer të paktën 2.5 vite të studimeve të tyre universitare në të njëjtin program studimi në një Universitet të akredituar jashtë Republikës së Sllovakisë;
- **Doktoratë/ Postdoktoratë/Lektorë/Kërkues/Artist (1-10 muaj):** Të gjithë kandidatët duhet të jenë të pajisur me një diplomë master.

Programi financohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Kërkimit dhe Sportit të Republikës së Sllovakisë dhe administrohet nga Agjencia Sllovaqe për Informacionin Akademik (Slovak academic Information Agency, SAIA).

Procedura e aplikimit realizohet dy herë në vit (në pranverë dhe vjeshtë). Afati i fundit i aplikimit për pranimet në pranverë 2020 është data **31 tetor 2019**, ndërsa për pranimet në vjeshtë 2020 është data **30 prill 2020**. Aplikimi realizohet online: www.scholarships.sk. Modalitetet lidhur me mbulimin e shpenzimeve në kuadër të Programit Kombëtar të Bursave të Republikës së Sllovakisë përcaktohen pasi kandidatët të jenë pranuar nga universitetet përkatëse sllovaqe për ndjekjen e studimeve në bazë të kualifikimit që ata zotërojnë.

Përzgjedhja e kandidatëve behet nga një Komision i Posaçëm i ngritur në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Kërkimit dhe Sportit të Republikës së Sllovakisë.

Kushtet për përfitim të bursës, përshkrimin e detajuar të degëve studimore, si dhe informacione të tjera rreth programit gjenden në faqen zyrtare të internetit:

<https://www.scholarships.sk>; www.saia.sk;

<https://www.scholarships.sk/en/news/summer-semester-academic-year-2018-2019-apply-now>;

<https://www.scholarships.sk/en/main/programme-terms-and-conditions/foreign-applicants>;

Gjithashtu, për pyetje në lidhje me Programin e Bursave Kombëtare kandidatët mund të kontaktojnë direkt me z. Ondrej ARADSKÝ, koordinator i këtij programi në adresën elektronike: nsp-foreign@saia.sk;

Drejtoria e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës